

Citimi i Referencave & Shmangëja nga Plagjiatura

Kolegji Universum

Autor: Alban Asllani



**KOLEGJI
UNIVERSUM**

Citimi i referencave & Shmangeja e plagjiaturës

Pse duhet të përmenden dhe citohen referencat?

- Duke i'u referuar material që ke përdorur si burim, ju i jepni autoritet punës suaj dhe në të njëjtën kohë tregoni gjërësinë e hulumtimit tuaj.
- Lista juaj e civateve do ti japë lexuesit mundësinë e gjetjes së informacionit
- Mos përdorimi i burimeve të informacionit për një ese, raport, projekt, punim, plan, analize, artikull apo libër përbën plagjiaturë, dhe mund të dënoheni për këtë. Rregulloret dhe ndeshkimet për plagjiaturë në Kolegjit Universum janë të theksuara në dokumentin për sjellje jo të mira akademike. Lexojeni këtë dokument më vëmendje.
- Studentët duhet të jenë të vetëdijshëm se Kolegji Universum e merr shumë seriozisht rastin e plagjiaturës dhe studentët mund të përjashtohen për këtë.

Format e referencimit

Dy sistemet kryesore standarde (por jo të gjitha) për të cituar referencat saktë janë: Sistemi i Harvardit (apo autori/data) dhe sistemi Vancouver (ose fusnota / fundshënime), i njohur ndryshe si sistemi numerik. Ka shumë variacione në të dy llojet, dhe në Kolegjin Universum ne ju mundësojmë të përdoren cilindo sistem që ju preferoni. Megjithatë, do të ishte mirë që të konsultoheni me profesorin tuaj se çfarë sistemi të referencimit ata kërkojnë nga ju për të përdorur në punimet, esetë, raportet, planet ose disertacionet tuaja. Ju jeni të lirë të përdoren atë sistem të citimit/referencimit duke u konsultuar me profesorin e lëndës paraprakisht.

Në publikime të revistave, dy versionet e referencimit përdoren gjerësisht, kjo varet nga "stili i shtëpisë botuese" të përshkruara në "Udhëzimet për autorët publikues".

Për burimet elektronike standardet janë ende duke u zhvilluar, por si me çdo sistem tjetër, *vazhdimësia është thelbi i zhvillimit*.

Sistemi 'Harvard'

- I njohur si sistemi "autori dhe data", referimet e bëra në tekst janë të listuara në bibliografi, në fund të tekstit duke filluar nga mbiemri i autorit të parë. Nëse autori është i panjohur ju duhet të përdoren "Anon".
- Në çdo vend në tekst ku keni cituar ndonjë publikim, në kllapa përfshijë mbiemrin e autorit, vitin e botimit dhe numrat e faqeve.
- Nëse ka më shumë se një punim nga një autor i caktuar, me të njëjtin vit të botimit/publikimit, ju mund të dalloni këto duke shtuar "a", "b", etj, pas vitit brenda kllapave.
- Nëse janë deri në tre autorë, përfshijë të gjithë emrat, e nëse ka më shumë se tre, jep mbiemrin e autorit të parë dhe inicialet për autorët tjerë.
- Titujt periodik shkruhen zakonisht në mënyrë të plotë

Shembull:

Referenca brenda esesë:

Në këtë hulumtim lidhur më benefitet qe sjellin kompanitë në ekonomi, Bloggs (Bloggs 1998) thekson se.....

Të dhënat në bibliografi:

Bloggs, B. ,1998. Financial Benefits and MNEs. London: Tadpole Press.

Sistemi ‘Vancouver’

- I njohur si “numerik” apo sistemi “fusnotë/fundshënim (endnotë)”; referencat janë të rradhitura njëra pas tjetrës sikur në tekst.
- Në secilën referencë të përdorur në tekst, përdor numrin e referencës në kllapa.
- Deri në gjashtë autor shkruaj të gjitha emrat; nëse ka më shumë se gjashtë, shkruaj mbiemrat e gjashtë autorëve të parë dhe initiale e autorëve të tjerë.
- Titujt e botimeve janë zakonisht të shkurtuar.

Shembull:

Referencimi brenda esesë:

Në hulumtimin e tij lidhur më benefitet qe sjellin kompanitë në ekonomi, Bloggs (1) theksoi se...

Të dhënat në bibliografi:

1. Bloggs, B. Financial Benefits and MNEs. London: Tadpole Press, 1998.

Si të referencohen librat në bibliografi¹

Elementet e referencimit janë të rregulluara në bazë të sistemit që përdoret, si për shembull:

Harvard

Mbiemri i autorit/ve, inicialet. (ed. apo eds. nëse editor). Viti i publikimeve. Titulli. Vendi i publikimit: Publikuesi.

Shembull:

- Dawkins, R., 1986. The blind Watchmaker. Harlow: Longman.
- Osborne, K. ed. 1995. Stonehenge and neighbouring monuments. London: English Heritage.

Vancouver

Mbiemri i autorit, inicialet (ed. Apo eds. Nëse editor). Titulli, Vendi i publikimit. Publikuesi, Viti i publikimit.

Shembull:

- Dawkins, R. The blind Watchmaker. Harlow: Longman, 1986.
- Osborne, K. ed. Stonehenge and neighbouring monuments. London: English Heritage, 1995.

Si të referencosh kapitujt/publikimet në bibliografi

Elementet e referencimit janë të rregulluara në bazë të sistemit që përdoret, si për shembull:

Harvard

Mbiemri i Autorit, inicialet. Viti i publikimit. Titulli i kapitullit/publikimit. Inicialet dhe mbiemri i Editorit. *Emri i librit*. Vendi i publikimit; Publikuesi.

- Scragg, D. G., 1991. The nature of Old English verse. In: M. Godden and M. Lapidge, eds., *The Cambridge companion to Old English literature*. Cambridge: Cambridge University Press.

Vancouver

Mbiemri i autorit, inicialet. Titulli i kapitullit/publikimi. Mbiemri dhe inicialet e Editorit, *Titulli i librit*. Vendi i publikimit. Publikuesi. Viti i publikimit.

- Scragg, D. G. The nature of Old English verse. In: M. Godden and M. Lapidge (eds.), *The Cambridge companion to Old English literature*. Cambridge: Cambridge University Press, 1991.

¹ Bibliografia përfshinë të gjitha referencat tuaja dhe literaturën e përdorur për të shkruar detyrat, punimet apo esetë tuaja

Si të referencohen artikujt e revistës/zhurnaleve në bibliografi

Elementet e referencimit janë të rregulluara në bazë të sistemit që përdoret, për shembull:

Harvard

Mbiemri i autorit, inicialet. Viti i publikimit. Titulli i artikullit. *Titulli i plotë i revistës*, Numri i volumit, (numri i publikimit): numri i faqës.

Shembull:

- Greenhalgh T. 1997. How to read a paper: the Medline database. *British Medical Journal*, 315 (7101): 180-183.

Vancouver

Mbiemri i autorit, inicialet. Titulli i artikullit. *Titulli i shkurtuar i shkrimit*. Viti; Numri i volumit; Numri i publikimit: numri i faqës

Shembull:

- Greenhalgh T. How to read a paper: the Medline database. *BMJ*. 1997; 315 (7101): 180-183.

Si të referencohen tezat/disertacionet në bibliografi

Referenca duhet të përmbajë informata e mëposhtme për të dy sistemet. Dallimi është se në sistemin Vancouver të referencimit, data duhet të lëvizë në fund.

- **HARVARD:** Asllani, A. 2006. Measuring Money demand in an economy: The case of Canada. MSc. thesis, Queen Mary, University of London.
- **VANCOUVER:** Matthews, V.C. The true self-knower: Central themes in Iris Murdoch's moral philosophy. Ph.D. thesis, King's College, University of London, 1998

Si të referencohen burimet elektronike në bibliografi

Zakonisht artikujt elektronik janë të njejta si ato të printuara, pra këto duhet të citohen njejt. Rekomandimet se si të citohen këto variojnë, pra shiqoni Web faqet e listuara më poshte dhe shiqoni tre shembujt rekomandues (të shenuara më poshte) dhe përdor atë që rekomandon departamenti juaj i programit. Për shembull departamenti i Biznesit dhe Menaxhmentit mund të këtë preferenca tjera nga departamenti i Administrates Publike.

- Asociacioni i Gjuhëve Moderne. Si ta dokumentoj burimin nga ëeb-i në listën time të citimeve? Shtator 8 2006 http://www.mla.org/style_faq4
- Asociacioni Amerikan i Psikologjisë. Shembuj të referencës për materiale më burim nga Web-i. Shtator 8 2006 nga <http://www.apastyle.org/elecsourse.html>
- Asociacionin për Hulumtime modern të Shkencave Humane. MHRA Style Guide. 2002 <http://www.mhra.org.uk/Publications/Books/StyleGuide/StyleGuideV1.pdf> [qasur në shtator 8 2006] (publikim online)

Si ti referencojmë emailat në bibliografi

Referenca mund të përfshijë të dhënat e mëposhtme:

Emri i autorit (email adresa), *Titulli i emailit*, (i pjerët apo i cituar). Emaili për(e-mail adresa). Data e dërguar. Data e leximit të emailit.

Shembull:

- Asllani, A. (alban.asllani@universum-ks.org), "Rregulloret dhe ndëshkimet për sjellje Jo të mire akademike". E-mail drejtuar të gjithë studenteve të Kolegjit Universum dhe Profesoreve në Email listen (info@ universum-ks.org). E Hene, 21 Janar 2013. [lexuar më 22 Janar 2013].
- Asllani, A. (alban.asllani@universum-ks.org), *Rregulloret dhe ndëshkimet për sjellje Jo të mire akademike*. E-mail drejtuar të gjithë studenteve të Kolegjit Universum dhe Profesoreve në Email listen (info@ universum-ks.org). E Hene, 21 Janar 2013. [lexuar më 22 Janar 2013].

Disa shkurtesa qe mund të perdoren në citime

| | |
|------------------------|---|
| Anon. | Autor i panjohur |
| c., ca. | Circa, për data të përafërta |
| cf. | Krahaso më |
| chap. | Kapitull |
| ed., eds. | Editor, editoret |
| et al. | Dhe të tjerë (et ali or et alia) |
| ibid. | Në të njejtin vend kam cituar edhe më lartë (ibidem) |
| loc. cit. | Në vend (apo punë) cituar (loco citato) |
| n.d. | Nuk ka datë |
| n.s. | Seri e re |
| s.l. | Nuk ka vend të publikimit (sine loco) |
| s.n. | Emri i publikuesit i panjohur (sine nomine) |
| op. cit. | Nga i njejt burim qe kam cituar më herët (opere citato) |
| p., pp. | Faqe, faqet |
| proc. | Vepruar |
| repr. | Riprintuar |
| rev. | Rishikuar |
| supp. or suppl. | Shtesë |
| trans. | Përkthyes/Përkthyer |

Këshilla për të parandaluar plagjiaturën

- Cito të gjitha burimet e marra, pavarësisht nëse i ke lexuar apo dëgjuar
- Mbajë shënime të plota për të gjitha burimet e informacionit që përdor
- Vendos thonjëzat për secilen pjese të tekstit qe merr fjalë për fjalë që.
- Përdor fjalët e tua kur përmbledh ose parafrazon punën e dikujt tjetër

Referenca për lexim të mëtutjeshëm:

Për të punuar këtë udhëzues, janë shfrytëzuar burimet e mëposhtme:

- University College London, 2012. Guidelines to Plagiarism, nga <http://www.ucl.ac.uk/current-students/guidelines/plagiarism>, [qasur në janar, 18, 2013]
- London School of Economics, 2012. Academic Regulations on Assessments, nga <http://www.lse.ac.uk/resources/calendar/academicRegulations/RegulationsOnAssessmentOf-fences-Plagiarism.htm>, [qasur në janar, 18, 2013]
- Yale College, 2012. Cheating, Plagiarism and Documentation, nga <http://yalecollege.yale.edu/content/cheating-plagiarism-and-documentation>. [qasur në janar, 20, 2013]
- Keele.org.uk, 2012. Documentations, nga <http://www.keele.org.uk/docs/index.htm>, [qasur në janar, 15, 2013]
- Plagiarism.org, <http://plagiarism.org/> [qasur në janar, 15, 2013]
- Plagiarism.org, Citing Sources, nga <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/> [qasur në janar, 15, 2013]
- Plagiarism.org, Ask the Experts, nga <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/> [qasur në janar, 15, 2013]
- Plagiarism.org, Resources, nga <http://plagiarism.org/resources/overview/> [qasur në janar, 15, 2013]

INFORMATA TË MËTUTJESHME DHE NDIHMË PËR STUDENTËT:

- Konsultohuni me profesorin tuaj
- Konsultohuni me Zyrën e Karrierës
- Konsultohuni me kolegët tuaj
- Konsultohuni me Zyrën për Siguri të Cilësisë
- Ju lutem shfletoni në Web faqet e mëposhtme për më shumë informacione:
 - <http://plagiarism.org/>
 - <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/>
 - <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/>
 - <http://plagiarism.org/resources/overview/>

INFORMATA TË MËTUTJESHME DHE NDIHMË PËR LIGJËRUESIT:

- Ju lutem konsultohuni më Zyrën për Siguri të Cilësisë
- Ju lutem shfletoni në Web faqet e mëposhtme për më shumë informacione:
 - <http://plagiarism.org/>
 - <http://plagiarism.org/citing-sources/overview/>
 - <http://plagiarism.org/ask-the-experts/overview/>
 - <http://plagiarism.org/resources/overview/>